

DEKLARATË
Datë 20.11.2006

Komisioni i Politikës së Jashtme i Kuvendit të Shqipërisë,

- Duke ndjekur me vëmendje zhvillimet e fundit për përcaktimin e statusit final të Kosovës;
- Duke përshëndetur angazhimin konstant të SHBA-së dhe BE-së për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe rezolutën e fundit të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, e cila kërkon përcaktimin e statusit final në përputhje me vullnetin e popullit të Kosovës;
- Duke mbështetur qëndrimet e Grupit të Kontaktit dhe deklaratat, sipas të cilave referendumi kushtetues e zgjedhjet në Serbi dhe çështja e statusit të Kosovës janë të pavarura prej njëra-tjetrës;
- Duke vlerësuar dhe mbështetur fuqishëm veprimtarinë e kryenegociatorit Marti Ahtisari për përfundimin dhe paraqitjen në afatin e parashikuar dhe pa vonesa të mëtejshme të dokumentit për statusin final të Kosovës në OKB;
- Duke vlerësuar progresin në arritjen e standardeve, si rezultat i veprimeve aktive të Qeverisë së Kosovës në bashkëpunim me UNMIK-un, si dhe rolin e madh të Grupit të Kontaktit në procesin e negociatave dhe në ruajtjen e kohezionit politik-institucional dhe publik në këtë fazë shumë të rëndësishme të përcaktimit të statusit;

Rithekson vullnetin e Kuvendit të Shqipërisë për përcaktimin e statusit final, ku pasqyrohen aspiratat dhe vullneti i lirë i qytetarëve të Kosovës për një shtet të pavarur, demokratik dhe europian.

Përshëndet me simpati të veçantë qëndrimet e urta dhe sjelljen demokratike të institucioneve, partive politike dhe opinionit publik në Kosovë dhe fton qytetarët e Kosovës që, duke ruajtur frymën e bashkëpunimit me faktorin ndërkombëtar, të shmangin çdo provokim dhe akt dhune, çka do t'u interesonte vetëm atyre që nuk kanë dashur dhe nuk duan zgjidhjen e drejtë dhe përfundimtare të statusit të Kosovës.

Rikonfirmon bindjen se zgjidhja e shpejtë e statusit final dhe respektimi rigoroz i kriterit të mosndarjes së Kosovës do të ndikonte pozitivisht në një zgjidhje të qëndrueshme e afatgjatë, ndërkohë që çdo shtyrje e mëtejshme apo përpjekje për ndarjen e Kosovës do të kishin pasoja për sigurinë dhe qëndrueshmërinë e krejt rajonit dhe më gjerë.